

VENDIM
Nr. 70, datë 6.2.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT
PUBLIK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE PËR TË DREJTAT E
PËRDORIMIT TË FREKUENCave**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 76, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për procedurën e konkurrimit publik për dhënie e autorizimeve individuale për të drejtat e përdorimit të frekuencave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi nr. 1252, datë 10.9.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLAT
**PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMEVE
INDIVIDUALE PËR TË DREJTAT E PËRDORIMIT TË FREKUENCave**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i rregullave për procedurën e konkurrimit publik për dhënie e autorizimeve individuale për të drejtat e përdorimit të frekuencave në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Këto rregulla zbatohen për procedurën e konkurrimit publik të zhvilluar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për dhënie e autorizimeve individuale, për përdorimin e spektrit të frekuencave, në rastin e kufizimit në numër të të drejtave të përdorimit të frekuencave, sipas parashikimeve në nenin 75, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike

në Republikën e Shqipërisë”.

KREU II ORGANIZIMI I PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PUBLIK

Neni 3

Vendimi për kufizimin e të drejtave të përdorimit

1. AKEP-i përgatit propozimin e arsyetuar për ministrin përgjegjës për komunikimet elektronike, vetëm pasi ka zhvilluar një proces konsultimi publik me palët e interesuara, i cili përfshin të gjitha elementet e parashikuara në pikën 6, të nenit 75, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Propozimi i AKEP-it për kufizimin e të drejtave të përdorimit përmban arsye të qarta për kufizimin e të drejtave të përdorimit.

2. Në përgatitjen e propozimit, sipas pikës 1, të këtij neni, AKEP-i mban parasysh përmbushjen e kriterëve ligjore për dhënien në përdorim të frekuencave, si dhe objektivat, për:

- a) promovimin e mbulimit me shërbime të komunikimeve elektronike;
- b) sigurimin e kërkesave të cilësisë së shërbimit;
- c) promovimin e përdorimit eficient të spektrit të frekuencave, duke marrë në konsideratë kushtet që i bashkëlidhen së drejtës së përdorimit dhe nivelin e pagesës;
- ç) promovimin e inovacionit dhe zhvillimin e biznesit;
- d) nxitjen e investimeve në rrjetet dhe shërbimet me kapacitet shumë të lartë, përfshirë rrjetet e gjeneratës së ardhshme;
- dh) promovimin e konkurrencës efektive dhe të qëndrueshme në tregun e komunikimeve elektronike;
- e) shmangien e akumulimit të spektrit në dëm të konkurrencës dhe hyrjeve të reja në treg, duke siguruar, në çdo rast, përdorimin eficient të spektrit, si burim i fundmë natyror;
- ë) sigurimin e mbulimit të gjerë me shërbime të komunikimeve elektronike të territorit dhe popullsisë së Republikës së Shqipërisë, me cilësi dhe shpejtësi të lartë, duke përfshirë mbulimin e rrugëve kryesore të transportit kombëtar dhe rrjetet e transportit transevropian;
- f) shpërndarjen e spektrit, që duhet të përmbushë qëllime ekonomike e teknike, përdorimin eficient dhe efikas të spektrit të frekuencave.

3. Konsultimi publik përfshin marrjen e opinionit të palëve të interesuara, për sa u përket:

- a) brezit apo brezave specifikë të frekuencave, si dhe ndarjen e tyre në lote;
- b) llojit të propozuar të konkurrimit publik dhe një vendimi të arsyetuar të detajuar për zgjedhjen e tij, bazuar në objektivat e konkurrimit publik;
- c) çmimit rezervë të propozuar për çdo brez ose lot spektri;
- ç) mënyrave dhe kushteve të pagesës për autorizimin;
- d) çdo kufi të vendosur mbi sasinë maksimale të spektrit për një ofertues ose pjesën e rezervuar të spektrit të propozuar për të promovuar konkurrencën;
- dh) kriterëve të pranimit për pjesëmarrje;
- e) kushteve dhe detyrimeve të propozuara, që do t’u bashkëngjiten të drejtave të përdorimit;
- ë) një afati kohor paraprak për procesin e konkurrimit publik.

4. Ministri, pas shqyrtimit të propozimit të AKEP-it dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe objektivat e përgjithshëm politikë, të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, miraton propozimin e AKEP-it dhe urdhëron fillimin e procedurës së konkurrimit publik.

5. Miratimi për fillimin e procedurës është publik dhe përmban detajet kryesore të alokimit të planifikuar, duke përfshirë bandat e frekuencave dhe objektivat kryesorë, që synohen të arrihen.

6. Në rastin kur në përfundim të konsultimit publik, AKEP-i arrin në konkluzionin, që nuk është i nevojshëm kufizimi në numër i të drejtave dhe kur nuk është në kundërshtim me interesin e përdoruesve ose të zhvillimit të konkurrencës ekonomike, i propozon ministrit dhënien e të drejtave të përdorimit, në përputhje me parashikimet e nenit 68, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, kundrejt pagesës së çmimit rezervë të miratuar nga ministri, bazuar në propozimin e AKEP-it.

Neni 4

Përzgjedhja e procedurës

1. Procedurat e konkurrimit publik, që ndjek AKEP-i për dhënien e autorizimeve individuale për spektrin e frekuencave, janë:

- a) procedurë konkurrimi për një brez frekuencash;
- b) procedurë konkurrimi me kombinim të brezave të frekuencave (*Multiband*).

2. Procedura “*Multiband*” ofron mundësinë e konkurrimit për të drejtat e përdorimit në disa breza frekuencash në një proces të vetëm konkurrimi. Procedura “*Multiband*” zhvillohet, në rastet kur:

- a) ekzistojnë frekuenca të lira në disa breza frekuencash, që mund të përdoren të kombinuara për ndërtimin e një rrjeti të komunikimeve elektronike;
- b) kombinimi i përdorimit të disa brezave të frekuencave i shërben përmbushjes së kërkesave për mbulim, efektivitetit të investimeve, rritjes së konkurrencës dhe interesit publik për maksimizimin e përfitimeve nga dhënia e të drejtave të përdorimit të frekuencave.

3. AKEP-i, në propozimin që i paraqet ministrit sipas nenit 3, të këtyre rregullave, i propozon dhe llojin e procedurës së konkurrimit, që zbatohet sipas pikës 1, të këtij neni.

KREU III

ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PUBLIK

Neni 5

Faza paraprake e pjesëmarrjes dhe dhënia e informacionit

1. Me miratimin nga ministri dhe përpara fillimit të publikimit të dokumentit të konkurrimit publik, AKEP-i organizon një fazë paraprake pjesëmarrjeje, me qëllim informimin dhe lehtësimin e përgatitjes së palëve të interesuara për pjesëmarrjen në konkurrimin publik.

2. Kjo fazë përfshin, por pa u kufizuar në:

a) publikimin e njoftimeve paraprake: njoftime për qëllimin e zhvillimit të konkurrimit, afatet kohore të pritshme dhe bandat e frekuencave të synuara. Këto njoftime do të bëhen të paktën dy (2) muaj përpara fillimit të fazës së aplikimit;

b) sesione informuese: takime publike ose *on-line* për të shpjeguar objektivat e konkurrimit, formatin e propozuar, kushtet kryesore dhe detyrimet e mundshme. Këto sesione do të mbahen brenda 1 (një) muaji nga publikimi i njoftimeve paraprake;

c) mundësinë për kërkesa paraprake për sqarime: një periudhë prej të paktën 2 (dy) javësh pas sesioneve informuese, gjatë së cilës palët e interesuara mund të paraqesin pyetje fillestare lidhur me procesin e konkurrimit ose specifikimet e frekuencave. AKEP-i do të publikojë përgjigjet në

mënyrë transparente;

ç) qasjen në dokumente paraprake: vënia në dispozicion e dokumenteve jodetyruese, si rregullore, studime tregu ose informacione teknike paraprake për të ndihmuar palët e interesuara në vlerësimin e mundësive. Këto dokumente do të jenë të aksesueshme, që nga publikimi i njoftimeve paraprake;

d) shprehjen e interesit: mundësinë për palët e interesuara për të regjistruar formalisht interesin e tyre për të marrë pjesë në konkurrimin publik, pa asnjë detyrim për pjesëmarrje përfundimtare.

3. Të gjitha aktivitetet dhe informacionet e ofruara gjatë kësaj faze paraprake janë transparente dhe të aksesueshme publikisht, duke siguruar barazi informacioni për të gjitha palët.

Neni 6

Dokumentacioni për procedurën e konkurrimit

1. AKEP-i harton dhe miraton dokumentin e konkurrimit publik, i cili përfshin:

a) informacione të përgjithshme, për:

- i. kuadrin ligjor të zbatueshëm;
- ii. formularin e njoftimit;
- iii. formularin e ofertës financiare;
- iv. formularin përmbledhës të vetëdeklarimit;
- v. deklaratën e konfidencialitetit;
- vi. kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes dhe të kualifikimit;
- vii. formularin e sigurimit të ofertës;
- viii. formularin e njoftimit të fituesit;
- ix. formularin e skualifikimit të ofertuesve;
- x. formularin e ankesës;
- xi. formularin e konfliktit të interesit;
- xii. formularin për botimin e fituesit.

b) informacione specifike, për:

- i. përcaktimin e frekuencës/brezit të frekuencave;
- ii. vlerën minimale të frekuencës/brezit të frekuencave;
- iii. autorizimin e përgjithshëm;
- iv. autorizimin individual për përdorimin e frekuencave;
- v. njoftimin dhe regjistrimin;
- vi. numeracionin;
- vii. interkoneksionin dhe aksesin;
- viii. tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- ix. informacionin e përgjithshëm për Shqipërinë (aspektet ekonomike, sociale, politike etj.);
- x. mënyrat e pagesës për autorizimin individual;
- xi. kushtet që i bashkëlidhen autorizimit individual;
- xii. etj.

c) Në rastin e zbatimit të procedurës me kombinim të brezave të frekuencave (*Multiband*), informacionet specifike, sipas shkronjës “b”, të këtij neni, jepen për secilin brez të përfshirë në kombinimin e brezave, në veçanti për përcaktimin e sasisë së frekuencave, vlerën minimale për brezin apo lotin përkatës.

Neni 7

Njësia e hartimit të dokumenteve dhe urdhri për zhvillimin e konkurrimit publik

1. AKEP-i siguron një ndarje të qartë të detyrave të personave të përfshirë në hartimin e dokumentit të konkurrimit publik dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave. Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh përpara emërimit të një anëtarë në njësinë e hartimit të dokumentacionit. Çdo person i përfshirë në procesin e zhvillimit të konkurrimit publik nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik, të miratuar nga ministri, kryetari i këshillit drejtues të AKEP-it nxjerr urdhrin për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- a) objektin e konkurrimit publik;
- b) procedurën e miratuar nga ministri, përfshirë dhe miratimin për mënyrat e pagesës;
- c) përbërjen e njësisë së hartimit të dokumenteve.

3. Njësia e hartimit të dokumenteve është përgjegjëse për hartimin e dokumentit të konkurrimit publik, hartimin dhe dërgimin e njoftimeve, brenda afateve të parashikuara nga këto rregulla, mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve të nevojshme, që kanë të bëjnë me konkurrimin publik.

4. Përpara zhvillimit të procedurës së konkurrimit publik, AKEP-i njofton publikisht për kryerjen e tij, si vijon:

- a) njoftimi për konkurrim publik botohet të paktën një herë në një gazetë me qarkullim ndërkombëtar, kur është e nevojshme, dhe dy herë në gazetë kombëtare/media;
- b) njoftimi publik shpallet edhe në faqen zyrtare të AKEP-it.

5. Njoftimi për konkurrim publik përfshin të gjitha informacionet, që u lejojnë subjekteve të interesuara të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e konkurrimit publik:

- a) afatin kohor, brenda të cilit do të dërgohen ofertat;
- b) vendin dhe adresën ku do të dërgohen ofertat;
- c) gjuhën ose gjuhët, në të cilën/at duhet të hartohen ofertat;
- ç) mënyrën dhe kushtet për marrjen e dokumentit të konkurrimit publik.

6. Ftesa për ofertë përmban informacion, por pa u kufizuar, për:

- a) objektin e konkurrimit publik;
- b) kushtet, kërkesat kualifikuese të kandidatëve;
- c) vlerën minimale të tregut për frekuencën ose brezin e frekuencave;
- ç) afatin përfundimtar dhe mënyrën e dërgimit të ofertave e të dokumenteve që i bashkëlidhen;
- d) adresën, vendin, datën dhe kohën e hapjes publike të ofertave;
- dh) personin e kontaktit;
- e) si dhe çdo informacion tjetër, që AKEP-i e vlerëson të dobishëm.

Neni 8

Komisioni i vlerësimit të ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) caktohet nga AKEP-i dhe përbëhet nga jo më pak se 4 (katër) përfaqësues të AKEP-it, specialistë të fushës përkatëse, 1 (një) përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për komunikimet elektronike, 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë.

2. KVO-ja është përgjegjëse për shqyrtimin dhe vlerësimin në tërësi të aplikimeve të ardhura,

në kuadër të procedurës së konkurrimit publik. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

3. Personat përgjegjës për hartimin e dokumentit të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të KVO-së.

4. Kryetari i komisionit përzgjidhet mes zyrtarëve të lartë, drejtues të AKEP-it, dhe është plotësisht përgjegjës për organizimin e punës, menjëherë pas krijimit të komisionit.

5. Komisioni zbaton detyrat e tij në pavarësi të plotë dhe, në rastet kur kërkon sqarim në lidhje me dokumentin e tenderit, i drejtohet njësisë për hartimin e dokumenteve për marrjen e sqarimeve përkatëse. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

6. Çdo anëtar i KVO-së nënshkruan një deklaratë, nëpërmjet të cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

7. Anëtarët e komisionit dhe çdo person, që ka marrë pjesë në procedurën e hartimit të dokumenteve, kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertës.

8. KVO-ja, në përfundim të procedurës së konkurrimit publik, dorëzon pranë AKEP-it raportin përmbledhës të procedurës së konkurrimit publik, i cili përmban:

- a) objektin e konkurrimit publik;
- b) përmbledhjen e procedurës së ndjekur;
- c) numrin e ofertave të paraqitura dhe një përmbledhje për çdo ofertë;
- ç) kriteret e vlerësimit të ofertave dhe vlerësimit në bazë të këtyre kriterëve për secilën ofertë;
- d) renditjen e ofertuesve, sipas vlerësimit të bërë nga komisioni;
- dh) ankesat, në rast se ka pasur.

Neni 9

Kriteret detyruese për skualifikim

1. Kandidati ofertues, i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, skualifikohet nga procedura e konkurrimit publik, në rastet e mëposhtme:

- a) Për kryerjen e njëres nga veprat penale:
 - i. pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - ii. korrupsion, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - iii. mashtrim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - iv. pastrim parash ose financim të terrorizmit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - v. vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - vi. ka lidhur marrëveshje me subjekte të tjera, që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
 - vii. falsifikim.
- b) Nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e tyre;
- c) Ka detyrime të pashlyera në lidhje me pagesën e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore, si dhe ndaj organeve tatimore apo çdo detyrim tjetër ndaj shtetit shqiptar, me përjashtim të rasteve, kur:
 - i. është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
 - ii. i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese, me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e

zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese, me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore, duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së konkurrimit.

ç) Ka falimentuar ose janë subjekt të procedurave të falimentimit.

2. Detyrimi për skualifikimin e një kandidati ofertues zbatohet edhe në rastet kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës, aksionar apo ortak i kandidatit ofertues ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje apo kontrolluese brenda tij.

3. Të gjitha kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare nga autoritetet përkatëse ose me anë të dokumenteve të tjera zyrtare, të lëshuara jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, përpara njoftimit për zhvillimin e konkurrimit publik, origjinal ose fotokopje të noterizuara. Nëse dokumentet e sipërpërmendura, për kandidatët ose ofertuesit e huaj nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim nga kandidati ose nga ofertuesi.

Përveç sa më sipër, ofertuesit e huaj i nënshtrohen një vlerësimi apo shqyrtimi, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara, në zbatim të ligjit nr. 7764, datë 2.11.1993, “Për investimet e huaja”, të ndryshuar, në përputhje me rregulloren e BE-së EU 2019/452/EU.

4. AKEP-i, kur nevojitet informacion për kandidatin ose ofertuesin rezident në një shtet të huaj, bashkëpunon me autoritetet përkatëse.

5. Ofertuesi nuk duhet të ketë anëtarë të bordit ose në nivelet drejtuese persona për të cilët ka vendim për masa shtrënguese nga Shqipëria ose nga BE-ja.

6. Mosplotësimi i njëjës prej kërkesave të sipërpërmendura në këtë nen përbën shkak për skualifikimin e kandidatit ofertues, pjesëmarrës në konkurrimin publik.

Neni 10

Kërkesa për kualifikim në procedurën e konkurrimit publik

1. Kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit publik kualifikohen në fazën e parë, pasi të kenë përmbushur kriteret e mëposhtme, që AKEP-i i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në pajtueshmëri me natyrën dhe përmasat e autorizimit individual, që do të jetë objekt konkurrimi dhe jodiskriminuese:

a) Kriteret ligjore:

i. janë shoqëri aksionare ose persona juridikë, të ngjashëm sipas legjislacionit të vendit ku ato janë krijuar dhe janë të regjistruara tek autoritetet përgjegjëse, ku ndodhet selia e tyre;

ii. mund të paraqesin oferta edhe bashkime investitorësh, që veprojnë së bashku për qëllime të pjesëmarrjes në konkurrim publik dhe që synojnë të kryejnë transaksionin nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet.

Kandidatët ofertues vërtetojnë përmbushjen e kriterëve ligjore për pajisjen me autorizim individual, përmes paraqitjes së certifikatës së regjistrimit në regjistrat tregtarë, ose në rastet e bashkimit të shoqërive, të vërtetojnë se i gëzojnë këto veti në kohën e marrjes së autorizimit individual.

b) Kualifikimi profesional: kandidatët duhet të vërtetojnë se zotërojnë njohuri të përgjithshme në fushën e komunikimeve elektronike, si dhe njohuri profesionale dhe eksperiencë për shfrytëzimin e frekuencave dhe teknologjitë që operojnë në atë brez, përkatësisht për brezin, objekt konkurrimi;

c) Aftësitë teknike:

i. Kandidatët duhet të paraqesin planin për shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit që do të ndërtohet dhe do të operojë në frekuencën/brezin e frekuencave, që është objekt tenderimi;

ii. Kandidatët duhet të paraqesin planin e tyre në lidhje me shërbimet, cilësinë e shërbimeve dhe/ose tarifat për shërbimet që do të ofrohen nëpërmjet rrjetit që do të operojë në frekuencën/brezin e frekuencave, që është objekt tenderimi, në varësi të rastit;

iii. Kandidatët duhet të garantojnë shfrytëzimin e frekuencave, në përputhje me rekomandimet dhe standardet e ITU-së dhe CEPT-it.

ç) Besueshmëria për sigurinë:

Ofertuesit duhet të paraqesin informacion për teknologjinë dhe furnizuesit e pajisjeve teknologjike që do të përdorin, duke dëshmuar që përmbushin kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi dhe standardet e sigurisë.

d) Gjendja ekonomike e financiare:

Ofertuesit vërtetojnë se zotërojnë kapacitete ekonomike e financiare për të përmbushur autorizimin individual, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet bilanceve financiare ose pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme, për një periudhë deri në 3 vjetët e fundit financiarë. Përfshihen nga detyrimi i dorëzimit të bilanceve dhe deklarata e xhiros së përgjithshme të shoqërisë, kandidatët të cilët kanë filluar ushtrimin e aktivitetit në vitin financiar në vijim.

2. AKEP-i është përgjegjës për përcaktimin e kërkesave të përgjithshme për kualifikim dhe kërkesave specifike në varësi të objektit të konkurrimit publik, në varësi të frekuencës/brezit të frekuencave, që do të jepet në përdorim.

3. Kërkesat teknike e profesionale synojnë të garantojnë shfrytëzimin e frytshëm dhe efektiv të spektrit, si dhe përmbushjen e objektivave të zhvillimit të sektorit, në raste të veçanta.

4. Dokumentacioni, në përmbushje të kërkesave të përgjithshme për kualifikim, paraqitet me shkrim dhe i shoqëruar me një deklaratë nga ofertuesi se, në rast se fiton të drejtën e përdorimit, do të respektojë përcaktimet në përgjigje të këtyre kërkesave. Deklarimet, në përgjigje të kërkesave të përgjithshme për kualifikim, bëhen pjesë përbërëse e autorizimit, nëse ofertuesi do të rezultojë i suksesshëm në marrjen e autorizimit.

Neni 11

Skualifikimi i kandidatëve

AKEP-i skualifikon në çdo kohë kandidatët ose ofertuesit, të cilët gjenden në një nga kushtet e përcaktuara në nenin 9 dhe nuk përmbushin kërkesat e nenit 10, të këtyre rregullave.

Neni 12

Anulimi i procedurës së konkurrimit publik

1. AKEP-i lejohet që në çdo kohë të anulojë procedurën e konkurrimit publik, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. AKEP-i në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një procedurë konkurrimi publik.

2. AKEP-i u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për anulimin e procedurës së konkurrimit publik, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit, dhe këtë njoftim e publikon në faqen e tij të internetit.

Paraqitja dhe pranimi i dokumentacionit

1. Kandidatët paraqesin dokumentacionin në përputhje me udhëzimet dhe kushtet e përcaktuara në dokumentin e konkurrimit publik, i cili përfshin:

- a) pranimin prej kandidatëve të kushteve të përcaktuara në njoftimin për konkurrim publik;
 - b) pranimin prej kandidatëve të detyrimeve, që rrjedhin nga fitimi i procedurës së konkurrimit publik;
 - c) pranimin prej kandidatëve të kushteve të dokumentit të konkurrimit publik.
- AKEP-i përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit.

2. Kur AKEP-i bën ndryshime në dokumentin e konkurrimit publik, njofton menjëherë të gjithë kandidatët, që kanë tërhequr dokumentet.

3. Dorëzimi i dokumentacionit:

a) Dokumentacioni dorëzohet me shkrim, dorazi ose përmes postës, i nënshkruar dhe i vulosur, i mbyllur në zarf, sipas përcaktimeve të dokumentit të konkurrimit publik;

b) AKEP-i, sipas kërkesës, pajis kandidatët me numrin e protokollit dhe datën e dorëzimit të dokumentacionit;

c) Dokumentacioni i dorëzuar, pas përfundimit të afatit të dorëzimit të tij, i kthehet i pahapur kandidatit që e ka dorëzuar. Të gjitha shpenzimet e kryera nga kandidati për përgatitjen e dokumentacionit nuk rimbursohen;

ç) Afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit për pjesëmarrje në konkurrimin publik është jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data në të cilën është botuar/publikuar nga AKEP-i, “Njoftimi për zhvillimin e konkurrimit publik”.

4. Sigurimi i ofertës:

a) Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë 2% e vlerës monetare minimale të tregut për frekuencën, të përcaktuar nga AKEP-i;

b) AKEP-i duhet të specifikojë në dokumentin e konkurrimit publik çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës;

c) AKEP-i nuk pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe e kthen menjëherë mbrapsht atë, nëse:

i. ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

ii. është anuluar procedura e konkurrimit publik, pa u shpallur fituesi.

5. Vlefshmëria, ndryshimi dhe tërheqja e ofertave:

a) Një ofertë është e vlefshme, nëse:

i. është dorëzuar në rrugë zyrtare në AKEP në datën dhe në kohën e përcaktuar në dokumentin e konkurrimit publik;

ii. kandidati plotëson kërkesat e njoftimit për konkurrim publik;

iii. kandidati jep garancitë e nevojshme;

iv. kandidati nuk është skualifikuar, sipas parashikimeve të këtyre rregullave.

b) Ofertat janë të vlefshme gjatë periudhës kohore të specifikuar në dokumentin e konkurrimit publik;

c) AKEP-i, përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave, mund t’u kërkojë kandidatëve të zgjasin këtë periudhë për një afat të caktuar. Në këtë rast:

i. kandidati mund të refuzojë kërkesën, pa humbur sigurimin e ofertës, dhe vlefshmëria e ofertës së tij përfundon me mbarimin e periudhës fillestare të vlefshmërisë;

ii. kur kandidati pranon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, me të zgjatet edhe sigurimi i

ofertës apo paraqitet një sigurim i ri oferte, që mbulon periudhën e zgjatur të vlefshmërisë. Kandidati, i cili nuk zgjat periudhën e sigurimit të ofertës ose që nuk paraqet një sigurim të ri oferte, vlerësohet se e ka refuzuar kërkesën për zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

6. Hapja e dokumentacionit:

a) Hapja dhe shqyrtimi i dokumentacionit bëhet nga komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), përbërja, të drejtat dhe detyrat e të cilit përcaktohen në këto rregulla;

b) KVO-ja hap të gjitha dosjet e aplikimeve në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e tij, ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar, pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentin e konkurrimit publik;

c) Emri, adresa e kandidatit ofertues, aplikimi i të cilit hapet, dokumentacioni ligjor, teknik, profesional, financiar dhe çdo dokument i kërkuar nga AKEP-i lexohen me zë të lartë për personat e pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së konkurrimit publik;

ç) Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo kandidat;

d) Njësia e hartimit të dokumenteve është e pranishme gjatë hapjes dhe vlerësimit të dokumentacionit, por anëtarët e saj nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japin mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe kryejnë funksione të karakterit ndihmës.

Neni 14

Shqyrtimi i aplikimeve dhe parakualifikimi

1. Pas hapjes dhe leximit të dokumentacionit, KVO-ja zhvillon një proces parakualifikimi për të verifikuar përmbushjen e kriterëve, të përcaktuara në nenet 9 dhe 10, të këtyre rregullave.

2. KVO-ja, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon kandidatëve sqarime me shkrim për shqyrtimin dhe vlerësimin sa më të drejtë të dokumentacionit të paraqitur në procedurën e konkurrimit publik.

3. Nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e sigurimit të ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

4. KVO-ja vlerëson se një aplikim është i vlefshëm edhe nëse ai përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentin e konkurrimit publik, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

5. KVO-ja nuk pranon një aplikim, në rastet kur:

a) kandidati nuk pranohet për shkaqe të përcaktuara në këto rregulla;

b) dokumentacioni i tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentin e konkurrimit publik.

6. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, KVO-ja njofton të gjithë kandidatët pjesëmarrës për rezultatet e kësaj faze dhe përgatit listën e kandidatëve që kanë përmbushur me sukses këtë fazë.

7. Çdo kandidat i interesuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data në të cilën është njoftuar, ka të drejtën e ankimit pranë AKEP-it.

8. Në përfundim të afateve të ankimit, AKEP-i njofton brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike kandidatët e parakualifikuar, që të dorëzojnë ofertat ekonomike, si kusht për vijimin e fazës tjetër të kualifikimit.

9. Në çdo rast, afati për përfundimin e fazës së parë të kualifikimit nuk kalon afatin 30 (tridhjetë)

ditë kalendarike nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit publik.

Neni 15

Dorëzimi i ofertës ekonomike

1. Kandidatët, që kanë kaluar fazën e parakualifikimit, dorëzojnë në AKEP ofertat ekonomike brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data në të cilën janë njoftuar, në përputhje me nenin 14, të këtyre rregullave.

2. Ofertat do të hapen në datën dhe orën e specifikuar në dokumentin e konkurrimit publik.

3. Ofertat do të jenë të pakthyeshme, pasi të dorëzohen në një raund, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në dokumentin e konkurrimit publik.

4. AKEP-i ruan informacionin konfidencial të komunikuar nga një kandidat/kandidatët ofertues, që merr/marrin pjesë në procedurën e konkurrimit dhe nuk e shpërndan atë, pa pëlqimin e këtij/këtyre të fundit.

5. Në rast se dy ose më shumë ofertues paraqesin oferta monetare të barabarta dhe më të larta për të njëjtin lot spektri, përcaktimi i ofertës fituese bëhet në përputhje me nenin 16 të këtyre rregullave.

Neni 16

Përcaktimi i fituesve dhe i çmimeve

1. AKEP-i përcakton ofertuesin fitues dhe çmimet përfundimtare për çdo lot spektri, në përputhje me kriteret e dhënies të specifikuara në dokumentin e konkurrimit publik.

2. Për çdo lot spektri, fitues shpallet ofertuesi që ka dorëzuar ofertën monetare më të lartë dhe të vlefshme.

3. Ofertë e vlefshme cilësohet vetëm ajo që është më e lartë ose e barabartë me çmimin rezervë (minimal), të përcaktuar për atë lot.

4. Në rast se dy ose më shumë ofertues paraqesin oferta me vlerë të barabartë për të njëjtin lot spektri, AKEP-i zbaton në rend përparësie mekanizmat e mëposhtëm, sipas radhës për zgjidhjen e barazisë, i cili specifikohet qartë në dokumentin e konkurrimit, konkretisht:

a) raund shtesë ofertimi (*Tie-Break Round*): vetëm ofertuesit me oferta të barabarta do të ftohen të marrin pjesë në një raund shtesë ofertimi, me rregulla të përcaktuara qartë (p.sh. raund me ofertë të mbyllur ose raund me rritje minimale). Ky raund zhvillohet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të ofertës, sipas nenit 15, të këtyre rregullave;

b) kriteret dytësore të paracaktuara: nëse raundi shtesë, sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij neni, nuk zgjidh barazinë, përdoren kriteret dytësore të paracaktuara, të cilat aplikohen me rend përparësie, si më poshtë vijon:

i. Detyrimet e mbulimit: oferta që parashikon detyrime më ambicioze të mbulimit (p.sh. përqindje më të lartë të popullsisë/territorit, mbulim në zona më të vështira gjeografike ose afate më të shkurtra për arritjen e objektivave të mbulimit). Këto detyrime duhet të jenë të matshme dhe të verifikueshme;

ii. Angazhimet për cilësinë e shërbimit (QoS): Oferta që ofron angazhime më të larta për cilësinë e shërbimit, përtej minimumit të kërkuar (p.sh. shpejtësi mesatare më të lartë të të dhënave, vonesë më të ulët, disponueshmëri më të lartë të rrjetit). Këto angazhime duhet të jenë të specifikuara dhe të matshme;

iii. Data dhe ora e dorëzimit të ofertës: Oferta e dorëzuar më herët në raundin përfundimtar të ofertimit. Ky kriter aplikohet në rastet kur AKEP-i disponon një sistem regjistrimi elektronik për dorëzimin e ofertave, i cili regjistron me saktësi kohën e dorëzimit dhe ky kriter është specifikuar si zgjidhës i barazisë.

c) Si mjet i fundit, nëse të gjithë mekanizmat e mësipërm nuk arrijnë të zgjidhin barazinë, AKEP-i mund të përdorë një short të rastësishëm dhe transparent. Shorti do të kryhet në prani të ofertuesve të interesuar ose përfaqësuesve të tyre dhe i gjithë procesi do të dokumentohet plotësisht.

5. Përcaktimi i fituesit/sve dhe çmimeve të dhënies së autorizimeve bëhet brenda 1 (një) muaji nga përfundimi i fazës së ofertës.

6. AKEP-i harton një raport të detajuar të vlerësimit të ofertës ekonomike, i cili përmban analizën e ofertave dhe arsyetimin e vendimit të dhënies së autorizimit individual.

Neni 17

Afatet e ankimit dhe rishikimi administrativ

1. Çdo kandidati ofertues i lind e drejta e rishikimit administrativ të procesit të konkurrimit publik, kur gjykon se një vendim i AKEP-it është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe me këto rregulla.

2. Ankesa paraqitet pranë këshillit drejtues të AKEP-it, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data kur ankimuesi është vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtyre rregullave.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, AKEP-i pezullon vazhdimin e procedurës së konkurrimit publik ose nxjerrjen e një vendimi, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht.

4. Këshilli drejtues i AKEP-it shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar, brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

5. Vendimi i AKEP-it i njoftohet ankuesit, jo më vonë se 3 (tre) ditë kalendarike nga marrja e këtij vendimi.

6. Kundër vendimit të AKEP-it mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mosmarrëveshjet administrative.

Neni 18

Ndërprerja e procesit të përzgjedhjes së fituesit

1. Procesi i përzgjedhjes së fituesit, në vijim të procedurës së konkurrimit publik, vazhdon edhe nëse numri i ofertave të vlefshme rezulton i barabartë ose më i vogël se numri i të drejtave të përdorimit të frekuencave në proces konkurrimi, duke respektuar rregullat e konkurrencës dhe objektivat e politikës për zhvillimin e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ndërprerja e procesit të përzgjedhjes së fituesit zbatohet vetëm në rast se, në përfundim të vlerësimit të ofertave, nuk rezulton asnjë ofertë e vlefshme.

2. AKEP-i, përpara fillimit të procedurës së re, sipas parashikimit të pikës 1, të këtij neni, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës së parë dhe i korrigjon ato, me qëllim që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës.

KREU IV

DHËNIA DHE DETYRIMET E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL

Neni 19

Njoftimi i fituesit dhe dhënia e autorizimit individual

1. AKEP-i, pas miratimit të raportit përmbledhës dhe me mbarimin e afateve të procedurës ankimore, sipas nenit 17, të këtyre rregullave, njofton fituesin në rrugë shkresore.
2. AKEP-i dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë autorizimin individual brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi i fituesit, periudhë e cila nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin dhe në dokumentet e konkurrimit publik.
3. Autorizimi individual hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga AKEP-i dhe pasi fituesi të këtë kryer pagesat e parashikuara në dokumentet e konkurrimit publik.
4. Kur ofertuesi fitues nuk arrin të nënshkruajë autorizimin individual, AKEP-i bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe për zgjedh ofertuesin e radhës në listën e ofertuesve që kanë mbetur. Kjo nuk cenon të drejtën e AKEP-it për të refuzuar të gjitha ofertat dhe për të anuluar procedurën e konkurrimit publik.
5. Autorizimi individual, i nënshkruar para përfundimit të afatit të njoftimit të fituesit apo para përfundimit të shqyrtimit administrativ, është absolutisht i pavlefshëm.

Neni 20

Detyrimet pas dhënies së autorizimit individual

1. Të drejtat e përdorimit të frekuencave janë subjekt i kushteve të përcaktuara në nenin 31, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. AKEP-i mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e autorizimit individual, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin dhe në dokumentin e konkurrimit publik.
3. Kushtet që rregullojnë zbatimin e autorizimit individual duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e tenderit.
4. Këto detyrime janë ligjërish të detyrueshme dhe subjekt i monitorimit nga AKEP-i.

KREU V

MONITORIMI I ZBATIMIT TË DETYRIMEVE

Neni 21

Monitorimi dhe zbatimi

1. AKEP-i monitoron vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të autorizimit individual për përdorim të frekuencave.
2. Në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga autorizimi individual, AKEP-i zbaton masat e parashikuara në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me përdorimin e frekuencave, kushteve të autorizimit, përfshirë kërkesat për mbulim dhe cilësi shërbimi.

KREU VI

Neni 22

Dispozita të veçanta

1. Ofertuesi fitues pajiset me autorizimin individual vetëm pasi të ketë kryer pagesat e parashikuara, sipas parashikimeve të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Çmimi i ofertës i ofruar nga ofertuesi, që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës / brezit të frekuencave, derdhet prej tij në buxhetin e shtetit.

3. Aplikimi i pagesës me këste në një procedurë për dhënien e autorizimit individual miratohet nga ministri, bazuar në propozimin e AKEP-it, në momentin e dhënies së miratimit për procedurën e konkurrimit publik, në rastet kur:

a) aplikimi i pagesës me këste përshpejton investimet për ofrimin e shërbimeve në interes të publikut dhe sjell rritje të konkurrencës;

b) subjekte të interesuara në procesin e këshillimit kanë kërkuar dhe kanë argumentuar aplikimin e saj në interes të shërbimeve ndaj publikut;

c) procedura për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në një brez të caktuar frekuencash është zhvilluar më shumë se dy herë dhe ka ende spektër të lirë të papërdorur.

4. Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, ofertuesi paraqet bashkë me ofertën dhe propozimin për kalendarin e kryerjes së pagesave me këste. Kalandari i kryerjes së pagesave me këste nuk mund të jetë më shumë se 1 (një) vit dhe pagesa e parë jo më pak se 20% e çmimit të ofertës dhe duhet të kryhet pas njoftimit të fituesit dhe para marrjes së autorizimit individual.

5. Kalandari i pagesave përfshihet në kushtet e autorizimit individual.

6. Ofertuesi paguan brenda 1 (një) viti, sipas kalendarit të propozuar në ofertë, pagesat e tjera përkatëse, pas pagesës 20% të çmimit të ofertës, plus interesin mbi këtë pagesë të llogaritur, sipas kursit të bonove të thesarit në momentin e paraqitjes së ofertës. Kryerja e pagesave me këste bëhet nga ofertuesi që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës/brezit të tenderuar në buxhetin e shtetit.

7. Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, afati kohor i sigurimit të ofertës është të paktën 30 (tridhjetë) ditë më shumë se afati maksimal i propozuar për kryerjen e plotë të pagesave.

8. Moskryerja e pagesave, sipas afateve të përcaktuara, çon në shfuqizimin e autorizimit individual nga AKEP-i dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës.

9. Aplikimi i pagesës me këste nuk e cenon të drejtën e çdo ofertuesi për paraqitjen e ofertës me një pagesë të vetme me marrjen e autorizimit.